



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Novobërdës ((KNB)), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve në kategoritë e ndryshme ekonomike në vlerë prej 129,449€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Novobërdës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna nuk ka arritur të verifikojë 20% të pronës në përputhje me Ligjin për tatimin në pronë, nr. 06/L-005.
- A2 Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike.
- A3 Angazhimi ikëshilltare me vendim të kryetarit pa i respektuar procedurat ligjore.
- B2 Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes të PVF-ve, si dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Novobërdës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Novobërdës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Novobërdës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Novobërdës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Novobërdës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa dobësi në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Këto dobësi kanë të bëjnë veçanërisht me menaxhimin e pasurisë, të hyrave, arkëtueshmeve, subvencioneve, si dhe me mallrat dhe shërbimet. Këto çështje janë paraqitur në formën e gjetjeve dhe rekomandimeve të mëposhtme për shqyrtim.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë synojnë përmirësimin e kontrollit të brendshëm lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke pasur parasysh kompetencat që lidhen me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Plani ynë është të rishikojmë dhe ndjekim këto rekomandime gjatë procesit të rishikimit të vitit të ardhshëm. Raporti ynë ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime, nga të cilat tri (3) janë përsëritura dhe tri (3) janë rekomandime të reja për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në raportin e Auditimit për Komunën e Novobërdës për vitin 2021 është prezantuar si e gjetur mos regjistrimi pasurisë, tokës dhe objekteve tjera në regjistrin kontabël dhe mos shpalosja në RVF, Në vitin 2022 Komuna kishte ndërmarrë veprime dhe kishte arritur të regjistroj në regjistra kontabël pasurinë në vlerë prej 55,268,904€, e cila ka të bëjë me tokën, objektet shëndetësorë, arsimore, ndërtesa administrative dhe struktura tjera. Ndërsa në vitin 2023 kishte arritur të regjistroj pasuri-tokë në regjistra kontabël në vlerë prej 146,745,669€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18, pika 3 e Rregullës Financiare të MF01/2013 - për shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të kenë kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për Planin Kontabël. Planin kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të zbatojë.

Nga dhjetë (10) mostrat e testuar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 135,893.77€, në dy raste, shpenzimi për blerjen e veturave zyrtare në vlerë prej 29,144€ është paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, nga kodi ekonomik. 13460 - Shërbime të tjera të kontraktuara, kur në fakt duhej të paguhej nga kategoria e investimeve kapitale.

Me vendim të Kryetarit të Komunës, gjatë vitit 2022 ishin angazhuar 12 këshilltar për çështje shëndetësore, sociale, shërbime publike, zhvillim të bujqësisë, kulturës rinis dhe sport etj. Gjatë vitit 2023, ata janë paguar nga kategoria mallrave dhe shërbimeve në vlerë 38,930€, dhe jo nga kategoria paga dhe shtesa.

Komuna kishte paguar OJQ-në në vlerë 61,375€, për shërbime të zjarfikësve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere. OJQ kishte angazhuar 32 zjarrefikes me qëllim të kryerjes së shërbimeve për komunën. Pagesat për shërbimet e tilla komuna duhet realizojë përmes shërbimeve kontraktuese tjera dhe të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime.

Arsyeja kryesore për këtë problem është mungesa e kontrollit të brendshëm adekuat, i cili synon të përcaktojë problemin dhe t'i tregojë menaxhmentit nevojën për eliminimin e parregullsive.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria joadekuate ndikojnë negativisht në klasifikimin e shpenzimeve në raportet financiare të komunës dhe si të tilla ofrojnë informata të pasakta për përdoruesit e PVF-ve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestিনি i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos verifikimi i pasurisë me qëllim mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Sipas nenit 15.2 të ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, aktivitetet inspektuese kryhen çdo vit në së paku 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.

Në vitin 2023, komuna shpërndau/faturoi fatura nga sistemi Protax për tatimin në pronë për 2,211 objekte, nga të cilat 75 ishin ndërtesa të reja. Komuna arriti të inspektojë (verifikojë) vetëm 22 objekte ose rreth 1%.

Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve.

Ndikimi Moskryerja e inspektimit të pasurive të paluajtshme/objekteve mund të rezultojë në informacion jo të plotë për gjendjen aktuale të pronës, të ardhura potencialisht më të ulëta të mbledhura në dobi të komunës, dhe gjithashtu mund të rezultojë në një ngarkesë tatimore joadekuate.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Subvencionimi pa thirrje publike

Gjetja Sipas nenit 12.1 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të organizatave joqeveritare (OJQ), çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me ftesë publike që duhet të publikohet në uebfaqen e ofruesit të mbështetjes financiare.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës me datën 01.02.2023, kryetari ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me organizatën joqeveritare në vlerë 60,276€ për një periudhë prej 6 muaj, nga 1 mars deri më 30 gusht 2023 për realizimin e projektit "Mbrojtja nga zjarri" me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale nga zjarri, fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera. Për zbatimin e kesaj marrëveshje nga neni 1, OJQ ofron 32 anëtar të shoqatës në rolin e zjarrfikësve të cilët do të punojnë në shërbim të komunës, përkatesisht në Drejtorin e Mbrojtjes - njesia e shpëtimit - zjarrfikësve. Kompensimi për secilin anëtarë të angazhuar ishte 303€ në muaj.

Shkak për këtë problem janë kontrollet joadekuate, si dhe mos zbatimi i rregullores së lartpërmendur.

Ndikimi Subvencionimi i OJQ-ve pa shpallur thirrje publike mund të çojë në përdorim joracional të buxhetit, mungesë transparence, si dhe mundësinë që mjetet t'u ndahen shfrytëzuesve të papërgjegjshëm.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen, me rastin e ndarjes së subvencioneve, të respektohen plotësisht të gjitha dispozitat e rregullores në fuqi, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me publikimin e shpalljeve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Angazhimi ikëshilltarë me vendim të kryetarit pa i respektuar procedurat ligjore

Gjetja Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2018 për emërimin e personelit ndihmës në komuna, në nenin 4 thotë se: “Për të ofruar ndihmë teknike administrative, kryetari i komunës mund të caktojë katër (4) zyrtarë ndihmës në zyrën e tij - Shef i Kabinetit, Zyrtar për marrëdhënie me publikun, Zyrtar Administrativ dhe Logjistik (shofer)”. Në nenin 7 thuhet gjithashtu se: “Për dhënien e këshillave dhe kryerjen e detyrave me përgjegjësi, kryetari i kryeqytetit mund të caktojë deri në pesë (5) këshilltarë”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se në Komunën e Novobërdës me vendim të kryetarit janë emëruar 12 këshilltarë. Këta këshilltarë janë caktuar për të dhënë këshilla në fushën e shëndetësisë, ekonomisë, ligjit, bujqësisë, kulturës, rinisë dhe sportit, komunitetet pakicë, shërbimet publike. Këshilltarët janë angazhuar për një periudhë kohore deri në skadimin e mandatit të kryetarit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurave ligjore me rastin e angazhimit të këshilltarëve në komunë.

Ndikimi Nëse emërimi dhe pagesa e këshilltarëve vazhdon pa e respektuar bazen ligjore, ekziston rreziku i shpenzimeve të paligjshme dhe të paqëllimshme të fondeve.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të rishikojë vendimet e marra për këshilltarët dhe të sigurojë respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në mënyrë që parregullsitë e tilla të identifikoheshin të mos përsëriten në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos përgatitja e raportit të inventarizimit para përgatitjes të PFV-së, si dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Sipas Rregullores Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Nenet 18 dhe 19 si dhe paragrafët 4.6 dhe 4.7 përcaktojnë që komisioni për inventarizimin e pasurive jo financiare, përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit si dhe hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Si dhe neni 6.3 përcakton se, pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të Kryetarit të Komunës me datë 27.12.2023, mirëpo komisioni nuk kishte përgatitur ndonjë raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PVF-ve. Po ashtu komuna nuk kishte regjistruar pasurinë jokapitale dhe stoqet në sistemin e-pasuria.

Mos kryerja e inventarizimit të pasurive dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi

Mos kryerja e plotë e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe mos funksionalizimi i sistemit të e-pasurisë rrit mundësin e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë jo financiare.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë jo financiare për të siguruar që pasuritë jo kapitale të regjistrohen në sistemin e-pasurisë. Po ashtu duhet siguruar krahasimi i gjendjes së pasurisë jo financiare sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektohen ndryshimet eventuale në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të arkëtueshmet

OB ka paraqitur kërkesa në PVF për vitin 2023 në vlerë prej 833,935.37€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë prej 723,014.52€, për dhënien e pronës në shfrytëzim 42,921€ dhe tatimit në biznes 68,000€. Rritja e të arkëtueshmeve mund të shihet vazhdimisht gjatë viteve. Në fund të vitit 2022 është paraqitur vlera prej 643,318.03€.

Çështja B3 - Menaxhimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas ligjit nr. 06/L-005 mbi tatimin në pronën neni 27. Nëse tatimpaguesi ose debitori nuk e ka paguar në tërësi tatimin dhe gjobën, nëse i është shqiptuar, ose detyrimet e prapambetura tatimore, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna bën njoftimin e fundit me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga skadimi i ditës së fundit për pagesën e borxhit, me të cilën kërkohet pagesa e shumës totale të detyrimeve të prapambetura jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike nga skadimi i ditës kur supozohet se debitori ka mundur të marrë njoftimin e fundit.

Në raportin financiar vjetor për vitin 2023, komuna ka prezantuar llogari të arkëtueshme (LLA) totale në vlerë prej 833,935.37€. Krahasuar me vitin paraprak, shuma totale e borxhit në vitin 2023 për tatimin në pronë është rritur për 23% dhe ka arritur në 723,014,52€, dhënia me qira e pronës është rritur për 9%, ndërsa taksa e biznesit, e cila është miratuar me vendim të Kuvendit të komunës në 2023 ishte 68,000€. Përmes testimit kemi konstatuar se komuna nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të arkëtueshmeve në pajtim me ligjin për tatimin në pronë. Duhet theksuar se këto borxhe kanë rritje ndër vite.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e nevojshëm të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Moszbatimi i mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të LL/A, gjë që rezulton në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe nxit debitorët e tjerë që të mos përmbushin detyrimet e tyre.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi paraqitur informacion të përmbledhur mbi burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e mjeteve dhe të hyrat e mbledhura sipas kategorive ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,329,628	4,288,521	4,061,733	3,200,636	2,901,588
Grante Qeveritare - Buxheti	3,029,342	3,510,722	3,445,606	2,622,015	2,529,864
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	32,132	7,013
Të bartura nga viti i kaluar	0	289,542	266,477	174,401	64,139
Të hyrat vetanake	300,286	300,286	195,189	200,990	199,723
Donacionet vendore	0	23,572	0	18,922	75,515
Donacionet e jashtme	0	164,399	154,460	152,175	25,335

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 958,893.43€. Arsyeja e rritjes është rritja e grantit qeveritar për 481,380.32€ dhe transferimi i të hyrave vetanake nga viti paraprak 289,541.78€, granti dhe donacioni i brendshëm (31) 23,572.44€, donacioni i BE-së(49) 142,495.92€, qeveria japoneze(59) 18,889€, qeveria zvicerane (61) 3,013.97€. Në kategorinë investime kapitale 239,969.51€, subvencione 130,380.13€, mallra 101,361.18€, shërbime komunale 4,267.39€ dhe paga dhe mëditje 482,915.22€.

Në vitin 2023, OB ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 4,061,732.84€, me një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë paraqitur më në detaje më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,329,628	4,288,521	4,061,733	3,200,636	2,901,588
Pagat dhe mëditjet	2,150,000	2,632,915	2,632,915	2,156,353	2,070,269
Mallrat dhe shërbimet	415,781	517,142	513,484	336,952	308,801
Komunalitë	90,000	94,267	91,508	83,636	69,585
Subvencionet dhe transferet	260,000	390,380	350,801	260,894	52,840
Investimet Kapitale	413,847	653,817	473,025	362,802	400,093

Shpjegimet e ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje është 2,632,915.13€, për këtë kategori është shpenzuar 100% e buxhetit të përgjithshëm;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është rritur për 101,361€, kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak 83,364€, buxheti nga donacionet 17,996€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 513,483€ ose 99%. 355,442€ janë shpenzuar nga granti qeveritar, 140,179€ nga të hyrat vetanake, 17,862€ nga donacioni i BE-së;
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere ishte 390,380€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 130,380€, kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak 130,380€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori janë 350,801€ apo 90%, nga granti qeveritar janë shpenzuar 139,000€, nga të hyrat vetanake 81,801€ dhe 130,000€ nga të hyrat e bartura nga viti paraprak. Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet e subvencioneve janë ulur me 10%;
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 239,970€, krahasuar me vitin paraprak 2022 është rritur për 68,853€ ose 12%. Në vitin 2023 është shpenzuar 72% e buxhetit, ose 473,025€, që është 10% më shumë se në vitin paraprak 2022. nga granti qeveritar për projekte kapitale është shpenzuar 82% e buxhetit, 32% nga të hyrat vetanake, 68% nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe 93% nga donacionet e jashtme.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e mbledhura nga Komuna e Novobërdës në vitin 2023 ishin 430,478€, që është 15% më shumë se në vitin paraprak, 2022. Ato kanë të bëjnë me të ardhurat nga taksat e pronës, të ardhurat nga lejet e ndërtimit dhe taksat administrative. Përveç këtyre të hyrave, komuna ka pranuar të hyra indirekte të inkasuara nga nivelet qendrore në vlerë prej 63,205€ (gjyba në trafik 12,250€ dhe të hyra gjyqësore 50,955€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti filleshtar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	300,286	300,286	430,478	364,088	344,312
Të hyrat tatimore	169,412	169,412	153,462	133,271	84,448
Të hyrat jo tatimore	130,874	130,874	277,016	230,817	259,864

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2022 ka rezultuar me katër (4) rekomandime. OB ka përgatitur një Plan Veprimi që tregon se si të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2023, komuna kishte zbatuar një (1) rekomandim, siç tregohet në grafikun 2 më poshtë. Për një përshkrim më të detajuar të rekomandimeve dhe se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (ose Tabelën e Rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e punonjësve për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës të emëruar që procesi i inventarizimit të kryhet me kohë, me qëllim të prezantimit të saktë dhe të drejtë në PFV. Po ashtu ti regjistroj pasurit jo kapitale dhe stoqet në sistemin e-pasuria.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nebojsa Ristić, Udhëheqës i ekipit



Stana Dancetović, Anëtare e ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Potvrdno pismo



POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2023 godinu kao
i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog pisma, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Novo Brdo, za godinu završno sa 31 decembrom 2023 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- slažem se / ne slažem se / delimično se slažem sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja (ovu tačku prilagodava entitet); i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Saša Milošević

Gradonačelnik Opštine,

Datum: 14.05.2024. Novo Brdo



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.